



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Akte të papublikuara

Ekstra 21

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Vendim i KM
nr.830, datë 1.12.2003

Për pajisjen e punonjësve të Gardës së Republikës të Shqipërisë me
armatim dhe mjete teknike të posaçme

3

Vendim i KM
nr.66, datë 14.1.2004

Për miratimin e rregullores së personelit të Gardës së Republikës të
Shqipërisë

7

VENDIM
Nr.830, datë 11.12.2003

PËR PAJISJEN E PUNONJËSVE TË GARDËS SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË ME
ARMATIM DHE MJETE TEKNIKE TË POSAÇME

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26 dhe 42 të ligjit nr.8869, datë 22.5.2003 "Për Gardën e Republikës së Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Rendit Publik, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e armatimit dhe të mjeteve teknike të posaçme, në përdorim të punonjësve të Gardës së Republikës të Shqipërisë, sipas tabelave nr.1, nr.2, nr.3 dhe nr.4 të cilat i bashkëlidhen këtij vendimi.

Ngarkohen Ministria e Rendit Publik dhe Garda e Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

TABELA NR.1
E
ARMATIMIT

Nr.	EMËRTIMI I ARMATIMIT	DESTINACIONI	SPECIFIKIME
	I. Armë dhe pajisje individuale		
1	Pistoleta të llojeve të ndryshme me 8 fishekë në krehër	Të gjithë nivelet e punonjësve	Pistoletë 7.62x39, pesha 910 gr, me 8 fishekë në krehër Pistoletë 9x18 m m, pesha 810 gr, me 8 fishekë në krehër Pistoletë 7.65-9 m m, pesha 700 gr, me 8 fishekë në krehër
2	Pistoleta me kapacitet mbi 8 fishekë në krehër	Punonjësit madhorë dhe grupet e shoqërimit	Pistoletë 9x18 m m, pesha 1020 gr, me 2 fishekë në krehër Pistoletë 9x19 m m, pesha 975 gr, me 15 fishekë në krehër Pistoletë automatike 9x19 m m, pesha 2 kg, me 30 fishekë në krehër Pistoleta 9x18 m m, pesha 700 gr, me mulli fishekë
3	Pistoletë elektrike	Për grupet e shoqërimit	Pistoleta elektrike me bateri të karikueshme (5000 vat)
4	Automatik 7.62m/m	Të gjitha nivelet e punonjësve	Automatik 7.62 m m x 39, pesha 4.3 kg me 30 fishekë në krehër
5	Automatik 9x19m/m	Grupet e shoqërimit	Automatik 9x19 m m, pesha 2.1 kg me 20-30 fishekë në krehër
6	Dylbi të llojeve të ndryshme për shikim ditën dhe natën	Nivelet madhore e të larta dhe në destinacion njësie, n/njësie	Dylbi 8x30, 7x50 për shikim ditën Dylbi me rreze infra të kuqe për shikim natën
	II.Armatim në destinacion njësie,		

	n/njësie, grupi		
1	Pushkë ceremoniali	Njësi, n/njësi	Pushkë 7.62 m/m, me bajonetë në formë thike, me krehër për shërbimet ceremoniale
2	Mitraloza të lehtë e të rëndë	Njësi, n/njësi	Mitraloza të lehtë 7.62x39 m/m me 100 fishekë në kuti Mitraloza të lehtë 7.62x51 m/m me 100 fishekë në kuti Mitraloza të rëndë 7.62x54 m/m me 250 fishekë në kuti
3	Pushkë snajper të llojeve të ndryshme	Grupet e n/grupet speciale	Pushkë snajper 7.62x21 me 5 fishekë në krehër Pushkë snajper 7.62x 51 Pushkë snajper 7.62 x 54 me 10 fishekë në krehër
4	Shutgan	Grupet e shoqërimit	Shutgan 12 m/m me 5 fishekë në magazinë Shutgan 40 m/m me 1 fishek në magazinë
5	Armë të lehta kundër tanke	Njësi, n/njësi	Granatahdhëse të lehta 40 m/m me shumë përdorime Arma k/tanke 75x67 m/m me një përdorim
6	Predha të drejtuara k/ajrore	Njësi	Predha të drejtuara k/ajrore të transportueshme me krah me infra të kuqe të destinuara për goditjen e objekteve ajrore që fluturojnë ulët
7	Busulla universale	Njësi, n/njësi	Busull dore universale me kuvimetër
8	Mjete mbrojtëse antiplumb	Njësi, n/njësi e grupet e shoqërimit	Jelek, xhaketa, kaska, mburoja e kokore policie
9	Kostum zhytës	Grupet speciale	
10	Shkopinj gome	Grupet speciale	
11	Pajisje trajnuese Simulator lazer	Qendra e trajnimit	Pajisje me rreze Lazer
12	Thika të ndryshme	Grupet speciale	Thika për vetëmbrojtje dhe përdorim special (sharrë)
13	Kompletimi me municion 3 kl për të gjitha llojet e armëve		
14	Fishekë të ndryshëm	Në përdorim individual e në destinacion	Municion 7.62 x 25 m/m, 9 x 18 m/m, 9 x 19 m/m, Municion 7.62 m/m x 39 m/m Municion 7.62 m/m x 51 m/m, 7.62 x 21 m/m Municion plastik 7.62 x 39 m/m; 7.62 x 51 m/m; 7.62 x 54m/m Municion trajnues 9 x 19 m/m
15	Pajime	Në përdorim individual e në destinacion	Krehër pistolete, 2 për çdo pistoletë Krehër automatiku 4 për çdo automatik Këllëf pistolete për rrip mesi dhe me rrip krahëqafë Mbajtëse municioni automatiku, mitralozi të lehtë e të rëndë Rripa universale

TABELA NR.2
E PAJISJE ME APARATURË E MJETE
TË SEKTORIT XHENIERO-KIMIK

--	--	--	--

NR.	APARATURA E MJETE	DESTINACIO NI	SPECIFIKIME
1	Aparatura zbulimi e kontrolli xhener	Për sektorin xhenero-kimik	Aparate minakërkues, portë elektrike, aparate Garret, stetoskopë, fluoroskop, aparat për zbulimin e avujve të LE, aparat zbulimi kimik, Drager, radiomatës, rentgenomatës
2	Mjetet mbrojtëse nga LE	Grupi antiminë	Jelet mbrojtës, kokore, mburojë, kostum antiminë
3	Mjete mbrojtëse KK	Për gjithë efektivin dhe PLSH	Kundragaze, kostum mbrojtës, çorape e doreza
4	Mjete çndotëse	Për gjithë efektivin	Paketa individuale K.K.
5	Mjete me natyrë policeske	Grupe speciale	Bombola, granata e fishekë me gaz lotsjellës
6	Teknike çndotëse e përpunimi	Spektori xhenero-kimik	Makina A.V.S., makina me autodush, matës degazimi, pompa degazimi
7	Lëndë çndotëse standarde	Spektori xhenero-kimik	Hipoklorit kalciumi, zbardhues tropikal etj.
8	Aparatura investiguese	Grupi antiminë	Kamera, aparat fotografik
9	Sistem zbulimi kimik, biologjik e radioaktiv Pajisje e vendosur në makinë (Toyota, Zil, Iveco)	Spektori xhenero-kimik	Kryen ZKR, këqyr në sipërfaqe rrethore, sinjalizon e jep informacion automatik për zbulimin që kryen
10	Makina çndotëse (Zil, Iveco)	"	Kryen çndotje, KBR, kapaciteti 2700 l, me një mbushje, çndot një rrugë 1400 m, me 5 m gjerësi, ekuipazhi 3 vetë
11	Makinë dushi fushor	"	Kryen përpunim shëndetësor me kapacitet 64 vetë në orë
12	Sistem çndotës shumëqëllimësh	"	I transportueshëm, përdoret edhe në objektet e brendshme për çndotje
13	Komplet zbulimi kimik e radioaktiv a) Rentgenomatës+radiomatës b) Aparat Drager	"	Monitoron rrezet beta+ gama, peshon 1.7-3.2 kg
14	Analizator i lëndëve kimike e toksike	"	Përcakton ekzistencën e 7 grupeve të lëndëve toksike. Përcakton direkt koncentrimin e substancave organike brenda 2 sekondave, ka sistem alarmi, peshon 3.6 kg.
15	Monitor të lëndëve kimike	"	Përdoret gjerësisht për trajnim dhe stërvitje të personelit
16	Pajisje alarmi atomike për lëndët kimike	Spektori xhenero-kimik	Jep sinjal automatik për lëndët toksike
17	Maskë k/gazi	Gjithë personeli	Ka aftësi mbrojtëse të lartë dhe peshë të vogël 1-1.2 kg
18	Doreza, çorape, pelerinë mbrojtëse k/kimike	Spektori+ njësitë	
19	Kostume mbrojtëse k/kimike	Spektori	Të jenë të manovrueshme jo më shumë se 3 kg.
20	Hipoklorit kalciumi, zbardhues subtropikal	"	60 – 65 % klor aktiv
21	Komplet filtër me kapacitet 100-	Për strehimet	Pastron ajrin dhe jep ajër të pastër në

	150, parafiltr		strehim
22	Granatë, fishekë e lëshues me gaz lotsjellës me natyrë policeske	Sektori+ grupet e shoqërimit	Kufiri ngacmues 0.05-0.1 mg/m ³ Kufiri toksikues 1-5 mg/m ³ Indeksi i avullimit 40.000-75.000 mg/min/m ³
23	Dedektor për zbulim minash nën tokë	Sektori	Zbulon minat metalike deri në 40 cm të futura në tokë
24	Dedektor për zbulim minash nën ujë	"	Zbulon minat e vendosura nën ujë dhe ato lundruese
25	Aparat me rreze x (rontgen)	"	Përcakton se çfarë ka brenda një objekti pa e lëvizur nga vendi
26	Aparat plasës në distancë	"	Shpërthen minat në distancë me telekomandë
27	Stetoskop	"	Zbulon minat me sahat
28	Floroskop	"	Kontrollon me kamera nëpërmjet një vrime të vogël se çfarë ka brenda një objekti
29	Robot çminimi minash	"	Heq minat pa rrezikuar njerëzit
30	Pushkë me ujë (distributor)	"	Shkatërron minat e bombat në distancë pa u prekur nga njerëzit
31	Komplete minimi e shkatërrimi	"	Mjete pune që përdoren nga specialistët
32	Pajisje laboratorit e kimikate	"	Përdoren për kryerjen e analizave të ndryshme

TABELA NR.3
E
MJETEVE TEKNIKE NË PËRDORIM

Nr.	APARATURA E MJETE	DESTINACIONI	SPECIFIKIME
1	Autovetura	Për grupet e shoqërimit VIP	Ngjyra: e zezë, me katër dyer Motor: me benzinë me cilindratë mbi 2490 cc Me ABC dhe Air Bag
2	Fuoristrada	Për grupet e shoqërimit VIP	Ngjyra: e zezë, me katër dyer Motor: me benzinë me cilindratë mbi 3000 cc Me ABC dhe Air Bag
3	Autovetura	Për shërbimet e personaliteteve	Motor: me benzinë- cilindratë mbi 1800 cc Me naftë-mbi 2500 cc, turbo-diesel Me ABC dhe Air Bag
4	Autovetura	Për shërbimet e tjera të Gardës	Motor: me cilindratë mbi 1500 cc
5	Mikrobusë Autobusë	Për transportin e punonjësve	8+1 vende, 4x4, diesel 12-16 vende, 2x4, diesel
6	Kamionë	Për transportin e punonjësve dhe të logjistikës	Kapaciteti mbartës 4 ton, me tendë, i përshtatshëm për transport punonjësish turbo-diesel, me dy diferencialë
7	Automjete	Shërbimet e Gardës	Për transporte dhe përdorime të veçanta
8	Motorë	Për shërbimet e delegacioneve	Ngjyra: e bardhë, me sirena dhe sinjalizues, cilindratë mbi 700 cc, me 4 kohë, me benzinë
9	Motorë	Shërbimet e Gardës	Motori me cilindratë mbi 200 cc
10	Helikopter	Për grupet e shoqërimit VIP	Dy motorë turbo reaktivë, fuqi mbi 1000 kf, mbi 5 vende

11	Motoskaf	Për grupet e shoqërimit VIP	Jaht me dy motorë, shpejtësi mbi 30 milje/orë
12	Evakues (transportues)	Për grupet e shoqërimit VIP dhe grupet speciale	6 deri 8+1 vende, shpejtësi 100 km/orë, me naftë, blindi të përballojë goditje direkte të predhës 15.5 m/m, dhe armatim të kalibrit deri në 30 m/m
13	Motoagregat	Për logjistikën	Mbi 2.5 kw
14	Pajisje atrecature	Për oficinën e riparimit të mjeteve	Sipas standardeve CE

Organika e mjeteve, kriteret e përdorimit dhe të shfrytëzimit përcaktohen nga Ministri i Rendit Publik.

Tanket T-59 dhe trbl A-521 do të qëndrojnë në kompletim deri me zëvendësimin e tyre me trbl me goma, sipas lidhjes 3/12.

VENDIM
Nr.66, datë 14.1.2004

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË PERSONELIT TË GARDËS SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 14 të ligjit nr.8869, datë 22.5.2003 “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Rendit Publik, Këshilli i Ministave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregulloreve të personelit të Gardës së Republikës të Shqipërisë, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ngarkohet Ministria e Rendit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

RREGULLORE
E PERSONELIT TË GARDËS SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË

KAPITULLI I PARË
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi dhe objekti

Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave dhe procedurave për pranimin dhe largimin e personelit të Gardës së Republikës, për zhvillimin e karrierës, për garantimin e të drejtave dhe për përcaktimin e detyrimeve të punonjësve në Gardën e Republikës, me synimin e krijimit të një shërbimi të qëndrueshëm e profesional.

Rregullorja përcakton skemën e administrimit të personelit të Gardës së Republikës dhe rregullon marrëdhëniet juridike ndërmjet punonjësve dhe administratës së saj në nivel drejtues.

Për çështje që nuk rregullohen shprehimisht nga kjo rregullore, do të zbatohet legjislacioni përkatës, Kodi i Punës dhe Statusi i nëpunësit civil.

Neni 2

Krijimi i marrëdhënieve juridike

Marrëdhëniet juridike të punës në Gardën e Republikës së Shqipërisë, për shtetasit që do të pranohen rishtas apo do të rimerren në detyra të nivelit të ulët, të mesëm e të lartë, do të krijohen për një afat kohor deri në pesë vjet me të drejtë ripërsëritje.

Kohëzgjatja e marrëdhënieve juridike përcaktohet nga dita e emërimit në detyrë dhe dita e largimit ose e përjashtimit nga Garda.

Detyrimet dhe të drejtat që lindin nga krijimi i marrëdhënieve juridike, përcaktohen me nen të veçantë në këtë rregullore.

KAPITULLI I DYTË

PRANIMI, FORMIMI DHE KUALIFIKIMI

Neni 3

Kriteret e pranimi

Në Gardën e Republikës, pranimi i punonjësve oficerë do të bëhet me konkurrim, në përputhje me nenin 11 të ligjit nr.8869, datë 22.5.2003 "Për Gardën e Republikës së Shqipërisë", si dhe procedurat e përcaktuara në këtë rregullore.

a) Për punonjës nënoficerë gardistë

Ka të drejtë të aplikojë për të konkurruar çdo shtetas shqiptar që plotëson kriteret:

1. Të mos jetë dënuar penalisht;
2. Të ketë sjellje të mirë qytetare;
3. Të jetë i aftë fizikisht dhe me gjatësi jo më pak se 175 cm; të ketë pamje të jashtme të rregullt;
4. Të ketë aftësi shëndetësore sipas kërkesave të testit shëndetësor të kësaj rregulloreje;
5. Të ketë kryer shërbimin ushtarak të detyrueshëm aktiv, duke i dhënë përparësi atyre shtetasve që kanë kryer shërbimin ushtarak aktiv pranë reparteve të Gardës së Republikës ose në repartet e Forcave Komando dhe paqeruajtëse;
6. Të ketë aftësi të plota për të vepruar;
7. Të ketë kryer Institutin e Policisë ose kurse të barasvlefshme me të;
8. Të jetë i moshës deri në 30 vjeç.

Nënoficeri gardist, që nga momenti i emërimit në detyrë, do të nënshkruajë kontratën sipas së cilës do të qëndrojë deri në 5 vjet në Gardën e Republikës, me të drejtë përsëritjeje.

Në grupet e shoqërimit dhe në trupën speciale pranohen ata shtetas që përveç plotësimit të kriterëve të mësipërme, të kenë kryer shërbimin ushtarak në reparte speciale (në Gardën e Republikës, zbulim, reparte komando, Policinë Ushtarake) dhe të jenë në moshën 23 deri në 30 vjeç. Koha e qëndrimit në këto shërbime të jetë: për trupat speciale deri në moshën 35 vjeç dhe grupet e shoqërimit deri në moshën 40 vjeç. Para caktimit të detyrave t'i nënshtrohen testeve të pranimi (testit të kontrollit shëndetësor dhe të përgatitjes fizike të miratuar nga komandanti i Gardës) dhe një kursi të përgatitjes speciale 3-4 mujor pranë Institutit të Gardës.

b) Për punonjësit e nivelit të mesëm (oficerë gardistë)

1. Të jetë i diplomuar pranë Akademisë së Policisë (me shkëputje nga puna) ose Akademisë Ushtarake "Skënderbej".

T'i nënshtrohet testit për pranim të kontrollit shëndetësor dhe të përgatitjes fizike të miratuar nga komandanti i Gardës, si dhe një kursi të përgatitjes profesionale (për shërbimet e Gardës) 1-3 mujor në Institutin e Gardës.

2. Për nevoja të sektorëve të veçantë të Gardës, ku kërkohen njohuri të posaçme, mund të pranohen shtetas me arsim të lartë civil, pasi të kenë kryer më parë kursin 3-4 mujor të formimit të përgjithshëm për shërbimet në Gardë, pranë Institutit të Gardës.

Gjatë periudhës të kursit, trajtimi financiar të bëhet me pagën bazë të funksionit organik më të ulët të nivelit të mesëm, për gradën e karrierës, si dhe vjetërsinë në punë të kandidatit.

Oficeri gardist, që nga momenti i emërimit në detyrë, do ta nënshkruajë kontratën, sipas së cilës do të qëndrojë deri në 5 vjet në Gardë, me të drejtë përsëritjeje.

Personeli që do të pranohet në grupet e shoqërimit dhe në trupën speciale, përveç kriterëve të mësipërme, duhet të plotësojë edhe këto kriterë:

- Të njohë një gjuhë të huaj (anglisht ose frëngjisht).

- Nga radhët e të diplomuarve në Akademinë Ushtarake të pranohen kuadro të diplomuar në specialitetin: gjitharmësh, zbulim dhe forcat speciale.

- Të kenë vjetërsi shërbimi policor ose ushtarak (në specialitet) mbi tre vjet dhe me vlerësime pune mbi nivelin mesatar.

- Të qëndrojë në këto shërbime deri në moshën 40 vjeç, ndërsa për detyra funksionale të veçanta të jenë mbi 40 vjeç dhe të kenë eksperiencë në këto shërbime mbi 5 vjet.

Para caktimit në detyrë t'i nënshtrohen testeve të pranimit dhe një kursi 4-mujor kualifikimi special, për shërbimin përkatës në Gardë, pranë Institutit të Gardës.

c) Për punonjës të nivelit të lartë (oficerë të lartë të Gardës)

Të jenë punonjës të nivelit të mesëm (oficerë gardistë) që të kenë kryer kualifikime profesionale dhe kurse drejtimi të nivelit të lartë (në përputhje me detyrën që do të kryejë).

Të zotërojnë një gjuhë të huaj (anglisht ose frëngjisht).

Neni 4

Rregullat e konkurrimit

Për pranim për nivelin e ulët (nënoficer gardist) organizohet konkurrimi me urdhër të komandantit të Gardës.

Njohja e aplikantit me rregullat e konkurrimit, literaturën për testim, normat e përgatitjes fizike, detyrimet dhe të drejtat bëhen nga sektori i personelit në Gardë.

Komandanti i Gardës përcakton radhën e punës për organizimin e konkurrimit, ku përcaktohet: hartimi, administrimi, vlerësimi i testit, normat përkatëse dhe sasia e pikëve, shpallja e rezultateve të konkurrimit etj.

Pranimi në konkurrim i kandidatëve për punonjës të nivelit të ulët (nënoficer gardistë) bëhet pas verifikimit dhe seleksionimit të dokumenteve të paraqitura prej tyre.

Kandidati me dokumentacion jo të plotë e të rregullt, me defekte fizike dhe me probleme shëndetësore (nën parametrat e përcaktuara në lidhjet e kësaj rregulloreje) skualifikohet.

Me kandidatët që plotësojnë kriteret zhvillohet testimi i pranimit.

Kandidatët fitues, me arsim të lartë policor ose ushtarak (të diplomuar në Institutin e Policisë ose në kurse në strukturat e Ministrisë së Mbrojtjes), para emërimit në detyrë, t'i nënshtrohen kursit 2-6 javë të përgatitjes profesionale për shërbimet në Gardë, pranë Institutit të Gardës. Gjatë periudhës së kursit të trajtimit financiar të bëhet me pagën bazë të funksionit organik më të ulët për nënoficerin gardist, për gradën e karrierës, si dhe vjetërsinë në punë të kandidatit.

Kandidatë fitues për oficer të nivelit të mesëm që janë me arsim të lartë civil ose ushtarak, policor, para emërimit në detyrë, t'i nënshtrohen kursit të trajnimit deri në katër muaj, të përgatitjes së përgjithshme dhe profesionale, për shërbimet në Gardë, pranë Institutit të Gardës. Gjatë kësaj periudhe, kandidatëve u sigurohet akomodimi, ushqimi sipas normës që ka efektivi i Gardës, uniforma e stërvitjes, si dhe shpenzime ditore në masën e 5 000 lekëve në muaj.

Punonjësit e Gardës së Republikës (të nivelit të ulët, të mesëm e të lartë), përveç punonjësve të administratës, logjistikës etj., i nënshtrohen çdo vit kontrollit mjekësor dhe atij të përgatitjes fizike, sipas normave dhe parametrave për çdo grup-moshë, të miratuar nga komandanti i Gardës. Mosarritja e parametrave normalë të testimit mjekësor e fizik, konsiderohet mosplotësim kriteri për të qenë personel i Gardës së Republikës, në funksione dhe vende pune operuese, si: nënreparte speciale, grupe shoqërimi etj.

Ritestimi mund të përsëritet vetëm një herë, 30 ditë pas testimit të parë, për atë pjesë të personelit që për arsye madhore të miratuar nga komandanti i Gardës nuk ka marrë pjesë në testimin e parë.

Komisioni i testimit miratohet çdo vit nga komandanti i Gardës. Në përbërje të komisionit janë drejtues drejtorie, dege, reparti apo sektori, specialistë të personelit dhe të fushave përkatëse (që mund të ftohen dhe nga institucione të tjera jashtë Gardës).

Rezultatet e komisionit të testimit, mjekësor dhe fizik, administrohen pranë personelit.

Neni 5

Dokumentacioni

A. Kandidatët për punonjës, nënoficerë, gardistë paraqesin këto dokumente pranë sektorit të personelit në Gardë:

1. Kërkesë me shkrim;
2. Kurikulum vitae;
3. Certifikatë lindjeje me fotografi dhe certifikatë të përbërjes familjare;
4. Dëshmi penaliteti (të marrë nga Ministria e Drejtësisë);
5. Vërtetim që nuk është në ndjekje penale (lëshuar nga organi i prokurorisë dhe i gjykatës);
6. Për meshkuj, vërtetim për kryerjen e shërbimit ushtarak (lëshuar nga dega e mobilizimit ku shtetasi ka vendbanimin e përhershëm);
7. Dy fotografi bust me përmasa 9 x 12 me xhakët dhe kravatë;
8. Certifikatë mjekësore (sipas modelit që ka testi i kontrollit shëndetësor. Ekzaminimi bëhet nga komisioni mjeko-ligjor në spitalin ushtarak, në prani të ekipit mjekësor të Gardës së Republikës, në bazë të kontratës që ka Garda me SUQ.

B. Të dhënat personale të kandidatëve fitues nga testimi për nënoficer gardist e oficer gardist, verifikohen e vërtetohen nga strukturat e personelit të Gardës e policisë ku kandidati ka vendbanimin e përhershëm.

Verifikimi dhe vërtetimi i të dhënave personale përshkruhen sipas modelit bashkëlidhur Rregullores së Personelit të Policisë së Shtetit, si dhe nënshkruhet nga titullari i organit të policisë.

C. Nënoficerët gardistë, oficerët gardistë para fillimit në detyrë bëjnë betimin para flamurit të Gardës në prani të Komandantit të Gardës sipas tekstit që vijon:

“Si pjesëtar i Gardës së Republikës betohem se do të jem gardist besnik i popullit tim trim, të disiplinuar, do të zbatoj kërkesat e Kushtetutës e të ligjeve dhe do të jem i gatshëm përherë, duke mos kursyer as jetën për kryerjen e detyrës. Ndëshkimi më i rëndë i ligjeve le të më jepet, nëse shkel këtë betim solemn! Betohem!”.

Me kryerjen e betimit, punonjësi i Gardës nënshkruan deklaratën e betimit, e cila depozitohet në dosjen personale.

Refuzimi për të bërë betimin dhe për të nënshkruar deklaratën e betimit sjell largimin e punonjësit nga Garda e Republikës.

D. Punonjësi i Gardës, pas betimit, nënshkruan kontratën individuale të punës, e cila nënshkruhet nga komandanti i Gardës dhe punonjësi gardist.

Modeli tip i kontratës, me të drejtat dhe detyrimet, i përmbahet akteve ligjore në fuqi, do të miratohet nga komandanti i Gardës dhe duhet të përmbajë:

1. Identitetin e palëve;
2. Vendin e punës;
3. Përshkrimin e përgjithshëm të punës;
4. Datën e fillimit të punës;
5. Kohëzgjatjen e marrëdhënieve të punës;
6. Kohëzgjatjen e pushimit vjetor (lejes së zakonshme deri 35 ditë kalendarike për nivelin e ulët, 40 ditë kalendarike për nivelin e mesëm dhe 45 ditë kalendarike për nivelin e lartë);
7. Elementet përbërëse të pagës dhe datën e dhënies së saj;
8. Kohën normale javore të punës;
9. Sanksionet për prishje të kontratës.

Neni 6
Specializimi e kualifikimi gjatë karrierës

Punonjësit e Gardës, gjatë karrierës, kualifikohen në përputhje me ligjin e gradave dhe me afate kohore të përcaktuara me urdhër të komandantit të Gardës për nivelin e ulët dhe me urdhër të Ministrisë të Rendit Publik për nivelin e mesëm e të lartë në Akademinë e Rendit, Akademinë Ushtarake dhe institucioneve të tjera brenda dhe jashtë vendit.

KAPITULLI I TRETË
KRITERET E PROCEDURAT E EMËRIMIT,
LARGIMIT APO PËRJASHTIMIT NGA DETYRA

Neni 7
Komisioni i emërtesës

Komisioni i emërtesës studion dhe i propozon komandantit të Gardës për emërimin, lirimin dhe lëvizjet e ndryshme për punonjësit e nivelit të lartë të Gardës së Republikës.

A. Komisioni i emërtesës përbëhet nga:

Komisioni i Emërtesës ka të drejtë t'i propozojë komandantit të Gardës për emërim, lëvizje, largim apo përjashtim nga detyra të punonjësve sipas kompetencave të përcaktuara në këtë rregullore.

- Titullari i komandës qendrore (kryetar i komisionit të emërtesës);

- Drejtorët e drejtorive operuese (për nivelet që kanë në varësi);

- Shefi i sektorit të personelit;

- Shefi i sektorit, eprorit ku punonësi ka vartësinë sektoriale dhe ai që e merr në varësi të tij.

Në qoftë se lëvizja bëhet brenda të njëjtit sektor, merr pjesë vetëm shefi i sektorit, eprorit që ka vartësi sektoriale;

- Përfaqësuesi ligjor në Gardë.

Vendimet e komisionit të emërtesës merren me shumicë votash dhe kur votat ndahen në mënyrë të barabartë, propozohet mendimi për të cilën ka votuar kryetari i komisionit të emërtesës.

Nuk mund të marrë pjesë në komisionin emërtesës punonjësi që diskutohet vetë për t'u emëruar apo liruar nga detyra.

Komisioni i emërtesës mbledhet sa herë që është e nevojshme dhe në çdo kohë, me propozim të shefit të personelit dhe miratim të komandantit të Gardës.

Dokumentet përkatëse, si dosja personale, vlerësimet e punës, propozimet e bëra nga eprorët e punonjësve të Gardës për t'i emëruar e liruar nga detyra, e të dhëna të tjera, komisionit të emërtesës i vihen në dispozicion nga sektori i personelit.

Si rregull, komisioni i emërtesës, nëpërmjet sektorit të personelit, i paraqitet komandantit të Gardës propozimet për personelin, në bazë të vendimeve të tij.

Diskutimet e bëra dhe propozimet konkrete për emërimet, të cilat diskuton komisioni i emërtesës për punonjësit e Gardës së Republikës paqyrohen në procesverbal të veçantë për çdo mbledhje të komisionit të emërtesës dhe procesverbali firmoset nga të gjithë anëtarët e komisionit, sektori i burimeve njerëzore i paraqet komandantit të Gardës, propozimet e bëra prej komisionit të emërtesës.

Neni 8
Kriteret e emërimit

A. Emërimi në detyrë i punonjësve oficerë e nënoficerë të Gardës së Republikës, bëhet në përputhje të plotë me kriteret e poshtëshënuara:

- Formimit dhe kualifikimit në përputhje me detyrën funksionale ku do të emërohet; - - Vjetërsinë në Gradë;

- Detyrat e kryera gjatë karrierës;

- Vlerësimet e punës;

- Vlerësimet të personalitetit.

B. Lidhja ndërmjet formimit të përgjithshëm (arsimimit) e kualifikimit profesional (dhe për

karrierë), gradës dhe vjetërsisë në shërbim për të gjitha nivelet e punonjësve të Gardës së Republikës përcaktohet me ligjin “Për gradat dhe karrierën në Gardën e Republikës së Shqipërisë”.

C .Vlerësimi i punës, aftësitë profesionale dhe të personalitetit

Çdo punonjësi të Gardës i bëhet vlerësimi i punës, i aftësive profesionale dhe i personalitetit.

Në vlerësimin e punës, aftësive profesionale dhe të personalitetit trajtohen problemet që vijnë:

I .Të dhëna personale:

- Emër, aftësi, mbiemër;
- Datëlindja, vendlindja, vendbanimi;
- Grada ushtarake, grada shkencore;
- Arsimi i përfunduar;
- Kualifikimet e kryera;
- Gjuhët e huaja;
- Data e titullimit;
- Detyra që ka kryer në vitin e fundit;
- Data e emërimit në detyrën e fundit;
- Reparti, sektori, zyra ku është efektiv dhe detyra funksionale;
- Stimuluar (gjatë periudhës që vlerësohet);
- Ndëshkuar (gjatë periudhës që vlerësohet).

II. Vlerësimi i punës (vetëm për oficerët)

Elementet që vlerësohen, përshkruhen sipas specifikës së detyrave funksionale që kryhen çdo punonjës dhe përcaktimeve që vijnë:

- Sasia e punës - aftësia për të kryer në kohë detyrat e planifikuara, shfrytëzimi maksimal i kohës së punës, qëndrimi aktiv e kërkues në punë e në shërbim, zgjidhja në kohë e detyrave dhe situatave të krijuara.

- Treguesit e punës – rezultatet konkrete në shërbimet e kryera duke përdorur metodën e krahasimit midis periudhash dhe punonjësish të së njëjtës detyrë.

- Cilësia e punës - kryerja e detyrave në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore, në përputhje me qëllimin që duhet të arrihet.

III. Vlerësimi i aftësive profesionale. Elementet që vlerësohen (vetëm për oficerët)

- Përgatitja profesionale – rezultatet e arritura në kurset e kualifikimit, specializimit, vlerësimi i bërë në testime.

- Kuptimi i detyrës – aftësia për të kuptuar dhe kryer detyrën në përputhje me qëllimin që duhet të arrihet.

- Shprehja dhe komunikimi – aftësia për t’u shprehur qartë, saktë e me kuptim, hyrja në bisedë me kolegët, eprorët, vartësit, publikun, shkëmbimi i mendimeve.

- Praktikiteti, iniciativa, bashkëpunimi - kryerja e detyrës pa teorizime, zbatimi në praktikë i njohurive të fituara në mënyrë të pavarur, nxitja në punë e të tjerëve.

IV. Vlerësimi i personalitetit. Elementet që vlerësohen

- Pastërtia e figurës – aftësia për të mos u kompromentuar.

- Drejtësia dhe korrektësia – aftësia për të qenë i paanshëm në përmbushjen e detyrës, zbatimi me përpikmëri dhe në kohë i saj, moskrijimi i privilegjeve për vete.

- Sjellja, paraqitje e jashtme- qëndrimi kundrejt detyrës, qëndrimi në marrëdhënie me kolegët, eprorët, vartësit, institucionet shtetërore, publikun, respektimi i hierarkisë, mbajtja e uniformës, tipare të tjera të karakterit.

V. Për punonjës në funksion drejtues në vlerësimin e punës, pasqyrohet si element më vete edhe qëndrimi si drejtues.

VI. Vlerësimi i punës si rregull bëhet vjetor dhe çdo përfundim viti, brenda muajit janar të vitit pasardhës dhe për raste të veçanta dhe gjatë vitit kur punonjësi transferohet, lëviz nga detyra, ulet ose ngrihet në detyrë, largohet apo përjashtohet nga Garda e Republikës etj.

VII. Vlerësimi bëhet nga eprori më i afërt i punonjësit të Gardës dhe në mungesë të tij nga eprori i eprorit të tij.

VIII. Me vlerësimin e punës njihet punonjësi që i bëhet vlerësimi i punës.

IX. Për personelin nënoficer gardist bëhet në një kopje (e cila administrohet në dosjen e tij

personale) dhe për personelin oficer në dy kopje (e cila administrohet një kopje në dosjen e tij personale në Gardë dhe një kopje në dosjen e Ministrisë), sipas modelit bashkëlidhur kësaj rregulloreje.

Neni 9

Transferimi dhe lëvizja

1. Transferimi (lëvizja) dhe emërimi në detyrë bëhet në përputhje me arsimin, kualifikimin, aftësitë organizuese e drejtuese, aftësitë profesionale për vendin e punës.

Lëvizja e nëpunësit të Gardës mund të bëhet për:

- a) Ngritje në detyrë;
- b) Ulje në detyrë;
- c) Me kërkesën e nëpunësit të Gardës;
- d) Transferim të detyruar duke mbajtur parasysh nevojat e Gardës, mbarëvajtjen në punë, kërkesat dhe nevojat e nëpunësit, gjithnjë duke ruajtur raportet e drejta për funksionet e caktuara;
- e) Për suprimim të vendit të punës.

Si rregull, në rastet e suprimimit të vendeve të punës mbahet në punë punonjësi që duke e krahasur me punonjësit e tjerë të organit, repartit, sektorit, ka:

- Formim e kualifikim më të lartë dhe që është në përputhje me detyrën që do të kryejë.
- Tregues më të lartë në testimin vjetor.
- Tregues më të lartë pune, të përshkruara në vlerësimet e punës së njëpasnjëshme, në dy-tre vitet e fundit.
- Për tregues të barabartë, largohet punonjësi që i suprimohet vendi i punës.

Deri në daljen e ligjit për gradat ndarja e roleve për efekt emërimi, lirimi dhe transmetimi të bëhet me urdhër të veçantë të Ministrit të Rendit Publik

Neni 10

Komandimi në detyrë

1. Komandimi në detyrë i punonjësve të Gardës është kompetencë e Ministrit të Rendit Publik dhe të komandantit të Gardës, sipas kompetencave të emërimit në detyrë.

Komandimi në detyrë mund të bëhet për funksionet organike që janë të vetëm ose të paplotësuar dhe që detyrat e tyre nuk mund të ndërpriten në asnjë moment.

2. Nuk lejohen të bëhen komandime:

kur organika e drejtorisë apo sektorit është e kompletuar.

Në funksione të punonjësit që është me leje të zakonshme, me raporte mjekësore, me përjashtim të rasteve kur raportet mjekësore janë të zgjatura mbi dy muaj.

Të oficerëve të nivelit të lartë, në funksione të personelit të nivelit të ulët (nënoficer gardist) dhe anasjelltas.

3. Afati i komandimit në detyrë në çfarëdo funksioni qoftë, është deri në dy muaj në vit.

Mbi dy muaj mund të zgjatet në ato raste kur punonjësi të jetë shkëputur nga puna si rezultat i marrjes së një raporti mjekësor të zgjatur dhe kur funksioni organik ka mbetur pa u plotësuar si rezultat i largimit nga puna të punonjësit paraardhës dhe kjo periudhë të zgjasë deri në një vit edhe për rastet kur është pezulluar.

4. Kryerja e detyrave në drejtori, degë, reparte, sektorë, zyra për periudha të veçanta, si në rastet e kryerjes e pushimit vjetor, raporte mjekësore e mungesa të tjera të kësaj natyre, do të bëhet nga shefi, eprori më i afërt ku punonjësi ka vartësinë funksionale, si dhe nga punonjës që janë në përbërje organike të drejtorisë, degës, repartit, sektorit, zyrës etj.

5. Gjatë kohës që punonjësi është i komanduar, nuk i zihet vendi i punës, si dhe paguhet ku është emëruar në organikë.

Neni 11

Pezullimi nga detyra

Punonjësi i Gardës pezullohet nga detyra kur shkel rregullat e parashikuara në rregulloren e disiplinës kur nuk ka vend për përgjegjësi penale deri në tre muaj ose deri në përfundim të çështjes

penale dhe gjatë kësaj periudhe trajtohet financiarisht, vetëm me pagën bazë pa shtesat e tjera.

Në përfundim të periudhës së pezullimit nga detyra punonjësi i Gardës rimerr vendin e tij në shërbimin që kishte dhe për rastet e pezullimit për përfundim të çështjes penale, rimerr dhe trajtimin financiar për periudhën e pezullimit, me përjashtim të rasteve kur shpallet fajtor

Gjatë kohës që punonjësi i Gardës është i pezulluar nga detyra nuk i zihet vendi i punës deri në marrjen e vendimit të formës së prerë.

Pezullimi nga detyra për rolet e larta bëhet nga Ministri i Rendit Publik, me propozim të komandantit të Gardës.

Neni 12

Vënia në dispozicion

Punonjësit oficerë e nënoficerë në Gardën e Republikës, për nevoja të riorganizimit strukturor dhe në pritje për sistemimin në një detyrë, në përputhje me gradën, formimin dhe aftësitë profesionale me miratim të komandantit të Gardës, mund të mbahen në dispozicion të Gardës deri në 2 muaj, duke u paguar me pagën e vendit që ka pasur. Pas këtij afati duhet të sistemohet në punë ose të largohet nga radhët e Gardës e të trajtohet financiarisht si punonjësit e larguar për suprimim të funksionit organik.

Neni 13

Largimet dhe përjashtimet nga Garda e Republikës

Punonjësit largohen dhe përjashtohen nga Garda e Republikës sipas rasteve të përcaktuara në nenin 14 të ligjit nr.8869, datë 22.5.2003 “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë”.

Punonjësi i Gardës largohet ose përjashtohet nga Garda e Republikës, përjashtimi bëhet i justifikuar dhe me praktikën përkatëse.

Kur punonjësi largohet me dëshirën e vet, paraqet kërkesën me shkrim për shkaqet e largimit në sektorin e personelit të paktën dy javë para datës së ndërprerjes së marrëdhënieve financiare.

KAPITULLI I KATËRT

TË DREJTAT DHE KOMPETENCAT PËR EMËRIMET DHE LIRIMET NGA DETYRA TË PERSONELIT

Neni 14

Të drejtat dhe kompetencat

Emërimi dhe liri nga detyra i punonjësve të Gardës, bëhet në përputhje me nenin 14 të ligjit nr.8869, datë 22.5.2003 “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë” dhe në përputhje me kriteret e procedurat e përcaktuara në këtë rregullore, si dhe me miratim të autoriteteve si vijon:

A. Ministri i Rendit Publik ka të drejtë dhe kompetencë:

1. T’i propozojë Kryeministrit emërimin dhe lirin nga detyra të komandantit të Gardës së Republikës.

2. T’i propozojë Kryeministrit emërimin dhe lirin nga detyra të oficerëve madhorë.

3. Emëron dhe liron nga detyra punonjësit e nivelit të lartë me propozim të komandantit të Gardës së Republikës.

4. Miraton vënien në dispozicion të Gardës oficerët që përfundojnë Akademinë e Policisë apo Akademinë Ushtarake për emërimin në detyrë; oficerët e nivelit të mesëm ose të lartë, që transferohen nga strukturat e policisë apo të ushtrisë në Gardën e Republikës.

5. Largon e përjashton nga Garda e Republikës, oficerët e nivelit të mesëm dhe të lartë në përputhje me nenin 14 të ligjit nr.8869, datë 22.5.2003 “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë”, me propozim të komandantit të Gardës së Republikës.

B. Komandanti i Gardës së Republikës:

1. I propozon Ministrit të Rendit Publik emërimin dhe lirin nga detyra të oficerëve të nivelit të lartë të Gardës së Republikës, emërimi i të cilëve në detyrë është kompetencë e Ministrit të Rendit Publik.

2. I propozon Ministrit të Rendit Publik, marrjen efektive në Gardën e Republikës dhe emërimin në detyrë të oficerëve që kanë përfunduar Akademinë e Policisë apo Akademinë Ushtarake,

transferimin dhe emërimin në detyrë të oficerëve të nivelit të mesëm, nga strukturat e tjera policore dhe ushtarake, emërimi i të cilëve është kompetencë e Ministrit të Rendit Publik.

3. I propozon Ministrit të Rendit Publik lirin nga detyra dhe largimin apo përjashtimin nga Garda e Republikës, në përputhje me nenin 14 të ligjit nr.8869, datë 22.5.2203 “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë” të oficerëve të nivelit të mesëm, largimi apo përjashtimi i të cilëve është kompetencë e Ministrit të Rendit Publik.

4. I propozon Ministrit transferimin në struktura të tjera, të punonjësve të roleve e niveleve të ndryshme sipas arsyeve të paraqitura.

5. Të lëvizë dhe të emërojë në detyrë punonjësit e nivelit të mesëm (oficerë gardistë) të Gardës së Republikës.

6. Të emërojë dhe të lirojë nga detyra punonjësit e nivelit të ulët (nënoficerët gardistë) të Gardës së Republikës.

7. Pranon dhe largon nga puna punonjës civilë, pranimi i të cilëve bëhet në bazë të Kodit të Punës.

KAPITULLI I PESËT NORMA TË FUNDIT

Neni 15

Inspektimi i punonjësve të Gardës

Inspektimi i punonjësve të Gardës së Republikës, bëhet nga drejtoritë, sektorët sipas vartësisë sektoriale në Ministri apo dhe nga struktura të veçanta pranë Ministrisë së Rendit Publik.

Aktkontrolli me propozime konkrete dhe tregues të dukshëm të evidentuar gjatë inspektimit, i dërgohet sektorit të personelit në Gardë dhe Drejtorisë së Burimeve Njerëzore në Ministri.

Neni 16

Procedurat dhe radha e punës së sektorit të personelit

Procedurat dhe veprimet administrative për emërimin dhe lirin nga detyra të punonjësve të Gardës së Republikës kryhen vetëm nëpërmjet sektorit të personelit në Gardë sipas radhës së punës të përcaktuara më poshtë.

- Propozimet e vlerësimet e punës të bëra nga eprorët për emërimin dhe lirin nga detyra të punonjësve që kanë në vartësi sektoriale; vendimet e komisionit të gradimeve, kërkesat për plotësime të mungesave organike të krijuara; vendimet e komisionit disiplinor që kanë lidhje me emërimet dhe lirimet apo masat disiplinore i paraqiten sektorit të personelit.

- Sektori i personelit për çdo punonjës përgatit relacion sqarues, me të cilin duhet të njihet kryetari i komisionit të emërtesës para mbledhjes së radhës.

- Për diskutimet e bëra në komisionin e emërtesës, mbahet procesverbal dhe në përfundim të mbledhjes, përpilon me shkrim aktin që quhet “Propozim”, i cili nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e komisionit të emërtesës.

- Për çdo propozim të bërë, sektori i personelit përgatit projekturdhërin dhe ia paraqet atë për miratim komandantit të Gardës dhe akti i miratuar nga komandanti i Gardës emërohet “Urdhër” ose “Propozim” për Ministrin e Rendit Publik, në varësi të kompetencave të emërimit dhe lirit në detyrë.

Akti i emërimit dhe lirit në detyrë përmban bazën ligjore, propozimin e komisionit të emërtesës, të dhënat e plota për punonjësin (emër, atësi, mbiemër, detyrën funksionale që ka dhe do të ketë, gradën, vjetërsinë, vështirësinë, motivacionin, pagën, datën e ndryshuar të marrëdhënieve financiare, datën e hyrjes në fuqi të urdhrit, si dhe nënshkrimin e titullarit).

- Akti i miratuar nga komandanti i Gardës dërgohet për zbatim sektorëve, reparteve sipas detyrimit.

- Akti i emërimit dhe lirimit nga detyra i komunikohet punonjësit nga sektori i personelit jo më vonë se 48 orë nga koha e protokollimit në sekretari. Njoftimi, i cili është i detyrueshëm, konfirmohet kundrejt nënshkrimit nga ana e punonjësit.
- Punonjësi me marrjen e njoftimit bën dorëzimin ose marrjen e detyrës konform dispozitave ligjore.

Neni 17

Ankimi dhe përfaqësimi

Kundër vendimeve për procedurat për emërimin dhe lirimin nga detyra, zgjidhja bëhet me ankim sipas procedurave të përcaktuara në rregulloren e disiplinës.

Përfaqësimi në Komisionin Disiplinor dhe në gjykatë, në rastet e uljes në detyrë apo përjashtimit nga Garda e Republikës bëhet nga eprori, superior i që ka propozuar uljen në detyrë apo përjashtimin nga Garda dhe përfaqësuesi ligjor në Gardë.

Neni 18

Kartoteka e personelit

Sektori, zyra e personelit krijon kartotekën për evidentimin e dokumenteve e dosjeve personale për punonjësit e Gardës së Republikës sipas ligjit nr.7726, datë 29.6.1993 “Për fondin arkivor kombëtar dhe për arkivat” dhe rregullores së kartotekës (të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore) të miratuar nga Ministri i Rendit Publik.

Neni 19

Dispozita kalimtare

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, do të ruajnë vendet e punës punonjësit që janë në përputhje me kriteret e ligjit “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë” dhe ato të miratuara në këtë rregullore. Punonjësit e tjerë do të emërohen në ato vende që janë në përputhje me kriteret e lartpërmendura ose do të dalin jashtë strukturave të Gardës për mosplotësim të kriterëve të kësaj rregulloreje.

Të gjitha aktet normative që vijnë në kundërshtim me këtë rregullore, shfuqizohen.

Kjo rregullore hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Fletorja Zyrtare gjendet:

Duke u abonuar për çdo vit pranë:

- çdo njësie postare të qyteteve;

- Qendrës së Publikimeve Zyrtare:

Bulevardi Zhan d'Ark, pranë ish-ekspozitës "Shqipëria Sot".

Tel: 042 555 63; 267 468

Për çdo lloj informacioni, shihni faqen e internetit në adresën:

www.legjislacioni.shqiptar.gov.al

Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare mund të gjeni:

BOTIMET:

1.	KUSHTETUTA (edhe anglisht)
2.	KODI I PROCEDURËS CIVILE
3.	KODI I PROCEDURËS PENALE
4.	KODI PENAL
5.	KODI I PUNËS
6.	KODI I FAMILJES
7.	KODI CIVIL
8.	KODI RRUGOR DHE LIGJI PËR TRANSPORTIN
9.	KODI ZGJEDHOR (i azhurnuar)
10.	KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE
11.	DISPOZITA ZBATUESE TË KODIT RRUGOR

PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI:

1.	PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PËRMBARIMIT
2.	PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PROKURIMIT PUBLIK
3.	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NËPUNËSIN CIVIL
4.	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SISTEMIN E DREJTËSISË
5.	PËRMBLEDHJE NË FUSHËN E TAKSAVE DHE TATIMEVE

DOLI NGA SHTYPI:

TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-KORRIK 2004

TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-KORRIK 2004

Doli nga shtypi më 7.10.2005

Tirazhi: 4300 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2005

Çmimi 100 lekë